Numri 3 Janar 2018

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

UniVlora Newsletter

Gëzuar Vitin e Ri 2018!

Shëndet, Lumturi dhe Sukces për Ju dhe familjet Tuaja.

Rektor Prof. Dr. Roland Zisi

Konferenca Studentore e Hapur 2017

Në daten 14 Dhjetor 2017 për herë të parë në ambjentet e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë pranë sallës "Rilindja" u zhvillua "Konferenca Studentore e Hapur 2017".
Pjesëmarrës në këtë Konferencë ishin studentë nga gjithë hapësira Shqiptare, të cilët paraqitën punimet e tyre shkencore në fusha të ndryshme si : Gjuhë Shqipe-Letërsi, Ekonomi, Edukim, Shëndet Publik, Biologji, Histori Gjeografi dhe a Drejtësi. E zhvilluar për herë të parë, kjo konferencë hedh një hap të ri dhe të rëndësishëm në vendosjen e rrugëve të reja të bashkëpunimit shkencor midis universiteteve, dhe pikërisht vendosjen e bashkëpunimit shkencor dhe studimor midis atyre që janë në fakt arsyeja e ekzistencës së universiteteve, studentëve. Në konferencë morrën pjesë edhe pjesa më e madhe e rektorëve të universiteteve publike shqiptare, të cilët I dhanë rëndësinë e duhur këtij aktiviteti..... f.4

Përmbajtja:

Çmimi Ekselencë Për Burimet Njerëzore Në Kërkim Për Uv-Në F. 2 * Video Promovuese E Uvës F. 2 * Marrëveshje Bashkëpunimi Me Dppi F.3 * Konferenca Studentore E Hapur 2017 F.4 * 1 Dhjetor 2015 Dita Botërore Kundër Hiv/Aids F.6 * Pjesa Teatrale "Qypi" F. 7 * Ceremoni Dhurimi Te Teksteve F.8 * Sa Më Pranë Fëmijve F.9 * Studenti Më I Mirë I Vitit F.10 * Promovimi Dhe Transparenca Brenda Institucioneve Politike Dhe Qeveritare F.11 * Sukses Kombetar I Studenteve Te Uv Ne Gjyqin Simulues Moot Court Albania, 2017 F. 11 * Hapen Aplikimet Për Të Rinjtë Shqiptarë Për Projektin Model European Union Strasbourg 2018! F. 12

Çmimi Ekselencë për Burimet Njerëzore në Kërkim për UV-në

Kemi kënaqësinë t'ju informoj se Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë i është akorduar çmimi Ekselencë për Burimet Njerëzore në Kërkim (HR Excellence in Research) nga Komisioni Evropian, në datë 4 dhjetor 2017. Kjo është një ngjarje e rëndësishme për ne dhe ajo na bën veçanërisht krenarë për tri arsye.

Së pari, kjo arritje finalizon përpjekjet disa mujore të institucionit tonë dhe justifikon punën e kryer nga ai për përgatitjen e dokumentacionit të kërkuar nga KE dhe përpilimin e aplikimit gjatë këtij viti.

Së dyti, ky çmim i jep një shtysë të rëndësishme promovimit të UV-së, në rang kombëtar dhe ndërkombëtar, si një institucion në të cilin nxitet një mjedis akademik dhe shkencor serioz, si dhe në përputhje me parimet e punës universitare bashkëkohore dhe evropiane.

Dhe së treti, UV-ja është universiteti i parë shqiptar dhe i vetmi që ka fituar këtë çmim, duke ju bashkuar rreth 400 institucioneve të arsimit të lartë në Evropë, të cilat e gëzojnë tashmë atë.

Akordimi i çmimit Ekselencë për Burimet Njerëzore në Kërkim bëhet për shkak të vlerësimit të Komisionit Evropian se tashmë institucioni ynë i njeh, i pranon dhe i ka bërë pjesë të veprimtarisë së tij praktikat dhe politikat evropiane për burimet njerëzore, dhe në veçanti ato të kërkuesve të rinj, në harmoni të plotë me parimet e Kartës dhe Kodit Evropian për kërkuesit. Kjo dëshmohet në analizën e brendshme përmbledhëse e cila shquan përparësitë dhe mangësitë në këtë drejtim, por edhe planit të veprimit, i cili do t'i parashtrohet Senatit Akademik të UV-së dhe do të zbatohet me rigorozitet duke filluar nga ky muaj.

Analiza si edhe plani i veprimit janë në faqen elektronike të UV-së (https://univlora.edu.al/2017/09/23/a-human-resources-strategy-for-researchers-incorporating-the-charter-and-code-university-of-vlora-ismail-qemali-albania/).

Ky çmim gjithashtu është një dëshmi reale e përkushtimit të vazhdueshëm të UV-së në përmirësimin e politikave të burimeve njerëzore, të cilat ngërthejnë çështje dhe aspekte që lidhen me punësimin, zhvillimin e karrierës akademike, etikës kërkimore, kushteve të punës, procedurave të promovimit, trajnimit, përgjegjshmërisë dhe besueshmërisë në publik dhe në tregun akademik, bashkëpunimit shkencor, projekteve kërkimore etj.

UV-ja ka një strategji konkrete për burimet njerëzore dhe kërkuesit dhe është e vendosur ta zbatojë atë me devotshmëri dhe profesionalizëm në kërkim të përmbushjeve të detyrave dhe angazhimeve në planin e veprimit dy-vjeçar dhe vlerësimit të jashtëm nga ekspertë ndërkombëtarë pas tri vitesh.

Zbatimi konkret i strategjisë sigurisht që kërkon një gjithë përfshirje të disa strukturave akademike dhe administrative në UV. Megjithatë, ky institucion nënvizon ambiciet për zbatimin e tij në linje me zotimet e ndërmarra në planin e veprimit, por njëkohësisht edhe në përputhje me disa prej rekomandimeve të lëna për të ardhmen nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë gjatë procesit të akreditimit, përmbushja e të cilave ngelet një prioritet i ngutshëm i UV-së në kohë dhe në cilësi. Në këtë kuadër, çmimi Ekselencë për Burimet Njerëzore në Kërkim është një ndihmesë dhe, patjetër, një shtysë e rëndësishme për plotësimin e tyre.

VIDEO PROMOVUESE E UVës

Ditën 14 Dhjetor u zhvillua ceremonia e vlerësimit dhe ndarja e çmimeve për të videot promovuese më të mira të UV-së.Juria përzgjodhi tre videot më të mira me autorë :

1. Ermal Toska FE
2. Marie Dema FE
3. Mario Alimucaj FSHH

I përgëzojmë studentët për punën e bërë dhe ju urojmë suksese të mëtejshme.

Marrëveshje Bashkëpunimi me DPPI

Mbështetur në Vendi- min Nr.100, datë 06.12.2017 të Senatit Akademik, me qëllim nxitjen e zhvillimit në fushën e shkencës dhe teknologjisë dhe inkurajimit të punës shkencore dhe kërkimore në Shqipëri, sot Rektori i Universitetit " Ismail Qemali" Vlorë Prof.Dr. Roland Zisi, nënshkroi Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI).

Marrëveshja ka për qëllim:

Rritjen e ndërgjegjësimit të studentëve , stafit akademik dhe profesionistëve të përfshirë në punëkërkimore dhe shkencore, për të drejtat që ata gëzojnë mbi punët e tyre

Krijimin dhe vënien në dispozicion të tyre të një sistemi efektiv të informacionit për arritjet e mëparshme (shpikjet) në fushat e ndryshme të shkencës.

Zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta si seminare, konferenca, ekspozita, trajnime të ndryshme që kanë për qëllim ndërgjegjësimin e studentëve, stafit akademik dhe kërkimor shkencor për rolin që ka mbrojtja e të drejtave mbi shpikjet në zhvillimin e shkencës dhe teknologjisë në vend.

Konferenca Studentore e Hapur 2017

Në daten 14 dhjetor 2017 për herë të parë në ambjentet e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë pranë sallës "Rilindja" u zhvillua "Konferenca Studentore e Hapur 2017".
Pjesëmarrës në këtë Konferencë ishin studentë nga gjithë hapësira Shqiptare, të cilët paraqitën punimet e tyre shkencore në fusha të ndryshme si : Gjuhë Shqipe-Letërsi, Ekonomi, Edukim, Shëndet Publik, Biologji, Histori Gjeografi dhe Drejtësi. E zhvilluar për herë të parë, kjo konferencë hedh një hap të ri dhe të rëndësishëm në vendosjen e rrugëve të reja të bashkëpunimit shkencor midis universiteteve, dhe pikërisht vendosjen e bashkëpunimit shkencor dhe studimor midis atyre që janë në fakt arsyeja e ekzistencës së universiteteve, studentëve. Në konferencë morrën pjesë edhe pjesa më e madhe e rektorëve të universiteteve publike shqiptare, të cilët I dhanë rëndësinë e duhur këtij aktiviteti.
Aktiviteti nisi me fjalën përshëndetëse të Rektorit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë Prof. Dr. Roland Zisi I cili gjithashtu I përcolli konferencës edhe përshëndetjen e Rektorit të UT, Prof. Dr Mynyr Koni. Gjithashtu përshëndetën edhe Rektore e Universitetit të Durrësit Prof. Dr. Kseanela Sotirovski, Rektori i Universitetit të Elbasanit Prof. Dr. Skënder Topi, Rektori i Universitetit të Korçës Prof. Dr. Ali Jashari, Rektori i Universitetit të Gjirokastrës Prof. Dr. Bektash Mema, Rektori i Universitetit të Arteve Prof. Dr. Kastriot Caushi.
Konferenca synon nëpërmjet prezantimit të arritjeve dhe metodave të ndryshme, të nxisë kërkimin shkencor në fusha të caktuara studimi. Gjithashtu, qëllimi i kësaj konference është vendosja e marrëdhënieve profesionale midis studentëve dhe ngritja e urave të bashkëunimit në kërkime të mëtejshme shkencore të mirëfillta .
Pjesëmarrësit në konferencë do të pajisen me çertifikata, kurse tre studentët me prezantimin më të mirë përveç Çertifikatës do të pajisen dhe me medalje.
Ky aktivitet përveç prezantimit ndërstudentor dhe vendosjes së bashkëpunimeve, shpreson gjithashtu të rrisë cilësinë e studimeve dhe kërkimeve në disiplinat shkencore, që ofron Universiteti i Vlorës.

KONFERENCË STUDENTORE

E HAPUR

14 DHJETOR, 2017

Universiteti "Ismail Qemali"

VLORË

Salla Rilindja, Rektorati

1 DHJETOR 2015

DITA BOTËRORE KUNDËR HIV/AIDS

Fakulteti i Shëndetit Publik i Universitetit "Ismail Qemali " Vlorë organizoi ne daten 1 dhjetor pranë sallës "Rilindja" aktivitetin e përvitshëm promocional, me rastin e 1 Dhjetorit, ditës Botërore të HIV/ AIDS . Në aktivitet morrën pjesë studentë të gjithë fakulteteve të UV-së. Çdo 1 Dhjetor duke filluar që nga viti 1988 njerëzit nga e gjithë bota bashkojnë forcat e tyre në luftën kundër HIV, tregojnë mbështetjen ndaj personave të prekur dhe kujtojnë ata që s'jetojnë më. Ky aktivitet ndërgjësues u drejtohet kryesisht studentëve dhe të rinjve, si grupmosha më e rrezikuar nga infeksioni i HIV . Ky aktivitet u organizua në bashkëpunim me Qëndrën Studimore për Shëndetin Publik si dhe me mbështetjen e Drejtorisë së Shëndetit Publik-Vlorë Në aktivitet u spjeguan rreziqet, si dhe mënyra e mbrojtjes prej tyre. Gjithashtu u theksua rëndësia e ndarjes së informacionit me familjarët, partnerin apo miqtë, si dhe drejtimi për ndihmë në Qëndrën për Këshillimin dhe Testim vullnetar të HIV/AIDS .

Pjesa Teatrale “Qypi”

Studentët e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë me rastin e 150 vjetorit të lindjes së Luigi Pirandello, paraqitën për herë të parë në Vlorë pjesën teatrale "QYPI", një përshtatje me skenarist dhe regjisor, Neritan Mehmetaj. Muzika e shkruar nga Maestro Aulon Naci; kostumet dhe skenografia janë nga Drini Shehu. "QYPI" është një nga romanet më të famshme të Luigi Pirandellos.Interpretimi i studentëve te UV -së ishte shumë dinjitoz. Suksese të mëtejshme për studentet :Elsamuel Nuredini, Thoma Ngresi, Ermelind Tafilaj, Andi Aliu, Fabiola Skrapalliu, Enxhi Nana, Kleart Kondaj, Elisa Mecaj, Klaudia Petraj dhe Aleksina Demiraj që pushtuan publikun me pasionin dhe shkathtësinë e madhe.



CEREMONI DHURIMI TË TEKSTEVE

Konsulle e përgjithshme e Italisë në Vlorë, Luana Alite Micheli, Përfaqësuesi Italian i Petroliferes Stefano Borghesi, kryetari dhomes së Tregetisë Arben Breshani, dy zv.rektoret e UV, Prof. Dr Bilal Shkurtaj dhe PhD Enkelejd Mehilli, Dekani i Fakultetit te Shkencave Teknike Prof.Asoc. Hajdar Kicaj, përgjegjësit e departamenteve ,stafi akademik dhe studentët e FSHT si dhe shumë pedagogë dhe studentë të tjerë të U V .

Në datën 05. 12. 2017 pranë Fakultetit të Shkencave Teknike, u organizua ceremonia e dhurimit të disa teksteve bashkëkohore, në fushën e Inxhinjerisë dhe Biologjisë. Ky donacion u mundësua nga Petrolifera Italo Albanese me ndërmjetësimin e Konsullatës së Përgjithshme të Italisë në Vlorë. Tekstet do të jenë në dispozicion të pedagogëve dhe studentëve të Fakultetit. Në takim morën pjesë Rektori i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë Prof. Dr. Roland Zisi,

Rektori i Universitetit vlerësoi bashkëpunimin e nisur dhe shprehu angazhimin dhe gatishmërinë e UV për bashkëpunime të mëtejshme. Ai falenderoi gjithashtu edhe përfaqësuesit e shtetit Italian për këtë inisiativë. Ceremonia u zhvillua në një frymë bashkëpunuese dhe shpresëdhënëse për bashkëpunime të tjera me këto institucione.

"Sa më pranë Fëmijëve"

Ne daten 22 dhjetor në Universitetin "Ismail Qemali "Vlorë, nën kujdesin e veçantë të Rektorit, Prof. Dr. Roland Zisi dhe Zv. Rektorit Ph.D Enkelejd Mëhilli, me sloganin "Sa më pranë fëmijve", u organizua një aktivitet bamirësie në dobi të fëmijëve të "Shtëpisë së Foshnjës" Vlorë. Aktiviteti u realizua me kontributet e: Fakultetit të Shkencave Teknike, Fakultetit të Ekonomisë, Stafi Adminstrativ i UV-së. UV falenderon gjithë personat që kontribuan në realizimin e këtyre çasteve të lumtur për këta fëmijë, dhe kujton se bamirësia është një kontribut human dhe qytetar në dobi të ndërtimit të një bote më të mirë për ne dhe fëmijët tanë.

Studenti më i Mirë i Vitit

Universiteti "Ismail Qemali " Vlorë, në kuadër të vlerësimit dhe motivimit të studentëve, si dhe të evidentimit të studentëve të shkëlqyer, ashtu si çdo vit do të zhvillojë aktivitetin "Studenti më i mirë i Vitit" për nivelet e studimeve Bachelor dhe Master.

Promovimi dhe transparenca brenda institucioneve politike dhe qeveritare

Sot në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë pranë sallës "C100" nën kujdesin e veçantë të shefit të Departmentit të Drejtësisë PhD Erjon Hitaj u organizua takimi mbi "Promovimin dhe transparencën brenda institucioneve politike dhe qeveritare, si dhe për transparencën e financave politike dhe zgjedhore të Partive Politike në Shqipëri" Në të morën pjesë studentë të UV, kryesisht të fakultetit të Drejtësisë.

Financat politike kanë provuar të jenë një çështje e vështirë në të gjithë botën dhe megjithatë ato luajnë një rol kritik në çdo demokraci.

Leksioni ishte konceptuar për të zgjeruar kuptueshmërinë tonë mbi parimet bazë për rregullimin e vendit dhe mwnyrws nga ku dhe se si partitë politike dhe kandidatët marrin paratë e nevojshme për funksionim politik dhe fushatën elektorale, si dhe justifikimin e shpenzimit të tyre. Gjithashtu u theksua se si standardet ligjore janë vënë në praktikë në vende të ndryshme dhe se si transparenca mund të përdoret si një mjet përgjegjshmërie. Ligjëruesja, Lisa Klein, mbështeti me përvojën e saj të gjerë si njohëse e mirë e kësaj fushe. Ajo ka shërbyer si Drejtoreshë e Komisionit Zgjedhor të Mbretërisë së Bashkuar për Partinë dhe Financat Zgjedhore nga viti 2007 deri në vitin 2012.

Sukses kombëtar i studentëve të UV në gjyqin simulues MOOT COURT ALBANIA, 2017

Studentet e Departamentit te Drejtesise, Doriana Canaliaj, Emiliana Bedini, Fjoralda Xhaferraj, Mersilda Lamaj, Dea Nini dhe Hajredin Dizdari, nen udheheqjen e pedagogeve Ertil Meçaj dhe Jonida Mehmetaj, perfaqesuan UV-ne ne gjyqin simulues MOOT COURT ALBANIA 2017 duke dale fitues ne finalen kombetare kundrejt skuadres se Universitetit shteteror te Tiranes me rezultatin 93-90. Skuadres VIRTUS te UV-se i lind e drejta te perfaqesoje Shqiperine ne MOOT COURT REGIONAL, qe do te mbahet ne Shkup te Maqedonise, ne muajin mars 2018. Rektori dhe stafi i UV-se pergezojne skuadren e studenteve te Departamentit te Drejtesise dhe iu urojne suksese ne finalen e Shkupit ne vitin 2018!

Hapen aplikimet për të rinjtë shqiptarë për projektin Model European Union Strasbourg 2018!

MEUS është simulimi më origjinal në botë i procesit vendimarrës të BE-së i cili zhvillohet në selinë e parlamentit europian në Strasburg. Konferenca mbledh bashkë 200 studentë dhe profesionistë të rinj tepër të motivuar, duke u dhënë atyre mundësinë e shkëlqyer për të pasur eksperiencë në funksionimin e institucioneve europiane në vetë zyrat e parlamentit eruropian. Për një javë, pjesëmarrësit kanë shansin për të marrë role si eurodeputetë, Ministratër i Këshillit të BE-së, gazetar, lobist dhe përkthyes (interpret) dhe të diskutojnë dy propozime legjislative kontrverse dhe të vërteta. Konferenca e këtij viti do të mbahet ndërmjet datave 21 dhe 28 prill 2018 dhe do të fokusohet në Privatsinë e Komunikimit Elektronik dhe Punës dhe balanca Punë-Jetë.

Konferenca nuk vetëm një mundësi unike për të përjetuar proceset vendim-marrëse dhe politikë-bërëse të BE-së por gjithashtu një mënyrë e shkëlqyer për të zhvilluar aftësitë e të folurit në publik dhe në zhvillimin e debateve konstruktive si dhe për të përmirësuar anglishten tuaj. Por edhe më e rëndësishmja, ju do të keni shansin të takoni njerëz nga e mbarë bota dhe të përjetoni një javë me një eksperiencë të paharrueshëme me plot aktivitete sociale.

Faza e aplikimeve do të mbyllet 17 Janar 2018, prandaj mos hezitoni të aplikoni!

Për më shumë infomacione vizitoni: http://www.meu-strasbourg.org ose kontaktoni me ne në https://www.facebook.com/meustrasbourg/

Model European Union Strasbourg

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE TONA

Universiteti Ismail Qemali Vlorë

U.V. Ismail Qemali

Universiteti Ismail Qemali Vlore

univlora2

Realizuar nga:
Zyra e Publikimeve
Sektori i Komunikimit dhe Publikimeve
Universiteti “Ismail Qemali” Vlore